

VOJSAVA NELO

SARANDA, KËNGA IME E DETIT

Eja në Sarandë!

ΣΑΡΑΝΤΑ, ΤΟ ΤΡΑΓΟΥΔΙ ΜΟΥ ΤΗΣ ΘΑΛΑΣΣΑΣ

Έλλα στους Αγίους Σαράντα!

SARANDA, MY SONG OF THE SEA

Come to Saranda!

POEMË

BOTIMET TOENA

Vojsava Nelo

SARANDA, KËNGA IME E DETIT

Eja në Sarandë!

ΣΑΡΑΝΤΑ, ΤΟ ΤΡΑΓΟΥΔΙ ΜΟΥ ΤΗΣ ΘΑΛΑΣΣΑΣ

Ελλα στους Αγίους Σαράντα!

Μετάφραση στα ελληνικά από τον

Andrea Zarballa

SARANDA, MY SONG OF THE SEA

Come to Saranda!

English translation by

Ukë Zenel Buçpapaj

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Artemida Jakllari

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Mirjana Madhi

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN: 9789928376664

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

Nderi i qytetit

I jepet: Zj. Vojsava Nelo

Për dashurinë kundrejt Sarandës të shprehur nëpërmjet kontributit tuaj real në promovimin dhe zhvillimin e aseteve dhe vlerave të saj. Saranda ka tek ju fuqinë e personalitetit të gruas dhe mbështetjen që i duhet, për një të nesërme më të bukur.

ADRIAN GURMA
KRYETAR I BASHKISË

Sarandë, më 8 Mars, 2023

*Falënderoj Bashkinë e Sarandës,
që financoi botimin e këtij libri,
kryetarin e saj, z. Adrian Gurma.*

*Me respekt e mirënjohje,
Vojsava Nelo*

*Këtë poemë, “Saranda, kënga ime e detit”,
që e përfundova sot, më 31 maj 2020,
do ta nis, me shpresë, në përjetësi.
Valët e detit ndoshta do ta përcjellin...
Deti Jon që prej thellësive gjëmon, ofshan,
këngëzon... Qielli i pafund ndoshta, ajo
kaltërsi... Ndoshta pulëbardhat, në mundshin,
me krahët e tyre, e mbi të gjitha njerëzit, njerëzit
gojë pas goje, me dashurinë që ua shoh në sy.
Po e nis sot.*

SARANDA, KËNGA IME E DETIT
Eja në Sarandë!
POEMË

**“Për mua deti është mrekulli
që s’ka mbarim.”**

Uollt UITMAN

Dikur, kur isha e vogël, fëmijë... Kur shkela për herë të parë në Sarandë, mbaj mend se, atë çast, m’u duk se hyra në një përrallë.

E nisa të eci... Ngadalë, ngadalë, si në përrallë, duke ecur e duke u magjepsur...

Saranda - ky qytet vezullues,
ku imagjinata lodron si askund. Pastaj nis
fluturimin mbi valë,
bashkë me pulëbardhat,
si një pulëbardhë.
Imagjinata ime poetike,
e magjepsur,
si askund.
Si rrallë.

Saranda - si një qytet i rrëshqitshëm
buzë ujërave, ku dritat notojnë e dalin sirenat
e këndojnë, e vallëzojnë, e dehin, e frymëzojnë...

Qyteti im i magjepsjes, Saranda,
ku dritat notojnë përmbi valë...
Ku sirenat këndojnë bashkë me njerëzit,
e dehin, e frymëzojnë çdo qenie të gjallë.
Poetin,
poetin si askënd tjetër.
Poetin,
si rrallë.

Saranda, e gjitha në dashurinë time.
Me të gjithë tingujt, ritmet,
valët,
dhe dallgëzimet e furishme të poezive.

E gjitha në frymëzimin tim,
si një anije me vela të bardha, të hapura,
që niset në detin e kaltër,
që herët,
në agim.

Saranda - në frymëzimin tim!
Magjia e saj e papërsëritshme.
E shndritshme.
e çon imagjinatën time,
përtej çdo orbite.

Saranda - muzë e fantazi. Qiell i hapur,
ku shkëlqejnë me mijëra e miliona yje
nga pikojnë
me mijëra e miliona poezi.

Përjetësisht të shndritshëm: toka, deti,
qielli me yje.

Të gjithë në muzën time.

Saranda, si fara e bekuar e bukurisë,
që mbin në çdo varg timin.

Në çdo këngë.

Që nga ajo që lind herët, në agim,
e deri tek ajo që lind natën, vonë,
nën qiellin prush me yj'.

Lidhja ime me ty është e hershme.

Që kur isha e vogël, fëmijë.

Është e përjetshme.

Sarandë,

përralla ime e mahnitshme,

me çdo grimcë, me çdo dallgë,

me çdo valë lozonjare,

që mbërrin në bregun tënd,

e që më deh,

që më grish,

e shpeshherë, më lë pa mend.

Unë e sodis dhe magjepsem.

Unë e sodis dhe mbushem me emocion.

Dhe ndiej se si filloj të dehem.

Dhe ndiej se si më frymëzon,

Saranda!

Shpirti im ngujuar këtu.

Përjetësisht këtu këndon...

Këtu, ku mund të arrish të prekësh qiellin me dorë,

diellin po deshe, hënën,

dhe çdo yll që feks e farfurit aty,

si të dojë të të bëjë magji.

Unë këtu, ngujuar.
Mbërthyer nga ky qytet.
Nga trajtat e tij të magjishme.
Nga çdo yll që farfurit e feks.
Nga ky det me valë,
e ngujuar,
si të dua të prek tërë thesaret e tij
mrekullitë pa skaj,
ku imagjinata ime fluturon si një pulëbardhë,
si një pulëbardhë mbi detin me valë,
e rrok të gjithë tingujt, të gjitha ritmet, të gjitha meloditë,
e të gjithë i shndërron, i bën poezi,
si askund tjetër, si askund,
as në tokë,
as lart, në qiejt prush me yj'.
Si të jesh yshtur prej Perëndive.
Si të shohësh një ëndërr.
Si të kesh hyrë në botën e madhe të poezive.

Sarandë!

Qyteti im i ndritshëm,
madhështor.
Si të jesh bërë me diamante.
Si të jesh stolisur me inxhi.
Mbushur me sirena që dalin netëve,
si për të marrosur çdo qenie të gjallë,

çdo njeri.

Shpirtrat dhe frymëzimet e çartura të poetëve.

Dhe unë, unë, që këtu ngujuar rri,

mbërthyer nga një frymëzim, që më vjen veç nga ti.

Një frymëzim përrallor,

si një simfoni që mund të pushtojë çdo shpirt njerëzor.

Çfarë simfonie?!

Heshtni, ju lutem!

Ju lutem, dëgjoni pak!

Çfarë simfonie ndihet?!

Dhe shpirti im,

dhe shpirti im,

që e shndërron, e bën poezi,

e bën varg.

Si një bekim qiellor kjo simfoni!

Dhe ajo melodi,

ajo melodi që valëzat e mërmërisin

ndërsa vijnë në breg

e japin shpirt aty,

duke të magjepsur me atë vetëflijim

për këngën,
për këngën dhe njerinë?!

Realitet apo ëndërr e gjallë?!

Unë këtu, ngujuar.
Unë këtu, si një peshk i kapur në grep.
Këtu, në këtë breg.
Këtu, në këtë qytet,
që të deh, që të magjeps, që të mbush me frymëzim.
Je apo s'je poet?!

Saranda ime mbushur me romanca.
Me njerëz, me jetë, me pulëbardha.
Me fluturimet e tyre poetike,
që imagjinata ime i ndjek në të gjithë kilometrat...
Në çdo skaj të qiellit, që s'ka fund.

Dhe janë ca fluturime të përjetshme...
Dhe janë ca fluturime të mahnitshme...

Dhe unë... dhe unë...
Mbërthyer këtu.
Këtu, në këtë botë të magjishme.

Në këtë botë të shndritshme,
si ta kem rrokur të tërën,
me tërë thesaret dhe mrekullitë e saj,
misteret pa skaj!

Dhe ti që shkon drejt aktit të krijimit,
si në ekstazë,
përfshirë prej frymëzimit.
Pak nga pak,
çast pas çasti,
derisa përpihesh e tëra nga flakët.
Flakët ngjiten nëpër trup.

Nëpër shpirt,
në mish,
në gjak.

Digjesh e tëra.
Shkrihesh.
Akti i madh i krijimit ndodhi.
Ndihet.
Flakërojnë të gjitha horizontet,
të gjitha ndjesitë.
Trup e shpirt.
Tokë e qiell.
Dhe ai diell që perëndon i kuqërremtë
bashkë me aktin e tij të kryer.

Aktin e madh të ndriçimit që pulson në ajër,
në tokë e në qiell,
në shpirtin e njeriut,
ai diell që shkrihet për t'u rilindur nesër,
nën këtë qiell.

Nesër,
një diell i ri do të shkrepë aty.

E përjetshme këtu ekstaza.
I përjetshëm frymëzimi yt!
I përjetshëm frymëzimi im!
Kjo ditë. Kjo natë. Ky diell. Kjo hënë.
Ky mister. Kjo magji.
Këtu unë jam ankoruar përjetësisht,
përjetësisht këtu, unë shkruaj poezi.

Më lini këtu!
Këtu dua të rri.
Të frymoj me këto valë.
Të vozis gjithë kënaqësi.

Të thur këngën time e dehur në frymëzim.
Nën kupolën e këtij qielli
zhytur në dritë e vezullim.

Më lini të mbushem me frymë!
Më lini në përjetimin tim!

Më lini të këndoj! Të derdh shpirtin tim!
Të qaj...
Të lotoj...
Më lini të shkruaj vargjet e mia
përpirë nga kjo natë.
Kjo natë magji. Kjo natë mrekulli!

Më lini, kjo natë të më përpijë!
Të më tresë, po deshi,
po deshi,
le të më shkrijë!

Më kishte marrë malli për këtë natë,
për këtë muzë.
Për këtë qytet, frymëzimi im i pamat.
Saranda ime!

Dashuria ime e pafund.
Shpirti i çdo vargu,
i çdo tingulli, i çdo poezie.

Më kishte marrë malli
për këtë qiell që shkëlqen në përjetësi
tek ti, veç tek ti.

Kjo natë, oh, kjo natë!
Kjo natë kaq e bukur, e mistershme,
e artë!

Gjithçka sikur hesht sonte.
Sikur nuk merr frymë. Sikur nuk është gjallë.
Kjo natë-magji,
si një himn madhështor, që zbret nga qiejt, lart,
dhe pushton çdo njeri.

Saranda!

Kam lotuar sa herë...
Po kurrë nga një bukuri.

Nga një natë si kjo, sonte.
Ekstazë, mister, magji,
dhe njerëz që duket sikur nuk frymojnë
pushtuar nga një supermrekulli:
Saranda!

Ca tinguj filluan të ndihen.
Njerëzit i dëgjojnë e zgjohen ngadalë...
Agimi i ri, si një pëshpëritje,
buzë këtij deti me valë.
Dita e re, dalëngadalë, çel në horizont
si një trëndafil i bardhë!

E mahnitshme!
E mahnitshme për imagjinatën time.
Për frymëzimin, që zë e ndizet në shpirtin tim,
në gjakun e valë.

Një erë e lehtë, tutje në horizont, duket sikur fryn
e zgjon ca trajta të mahnitshme
të ditës së re që vjen,
duke ndezur imagjinatën poetike...
Duke e fladitur ëmbëlsisht,
dalëngadalë,

buzë këtij deti nanuritës,
pranë këtij bregu me valë...

Një pulëbardhë sapo u nis e vetme,
si një gjethe që përkundet në fluturim...
Si të ndjellë shpirtrat e njerëzve,
në këtë mëngjes,
në këtë zgjim.

Pas saj,
tufa pulëbardhash si të shpërndajnë me krahët e
tyre valëvitëse
vargje poetësh. Poezi.
Të gjitha të mahnitshme.
Dhe unë, si të këndoj nga maja më e lartë e botës.
Nga kopshti më i lulëzuar.
Buzë këtij deti të përsosur,
përsosmërisht e frymëzuar.

Saranda ime!
Mëngjesi tek ti. Mbrëmja tek ti.

Rruga për tek ti,
gjithçka shtruar me petale.
Kushdo që mund të vijë,
le të niset. Të vijë.
Se do të prekë një botë imagjinare,
një botë që do të mbetet në shpirtin e tij.

Do të shndërrohesh në diell, këtu.
Do të shndërrohesh në kaltërsi.
Do të zhytsh në lumturi, si pa e kuptuar,
në një botë,
që është pa kufij.

Kraharori im i mbushur me valët e tua,
me pulëbardha që fluturojnë në përjetësi...
Unë, nëpër udhëtimet e mia.
Me vete marr gjithmonë mallin tënd.
Mallin që herë pas here
më rikthen tek ti.
E, me t'u afruar, me t'u shfaqur,
si qeshet deti?! Si qeshem unë?!
Si ngrihen mal ca dallgë gëzimi
të njerëzve që më presin,
që nuk më kanë harruar,
ata që gjithmonë më kanë dashur e vazhdojnë të
më duan.

Këtu. Askund tjetër. Askund.
Nuk gjenden njerëz që më duan më shumë.
Valë kaq të qeshura, që qeshin.
Oh, si qeshin sapo shfaqem unë?!

Dallgë të mëdha gëzimi, të mbushura me shkumë,
dhe një breg i tërë mbushur me tinguj përmallimi

dhe ca melodi të papërshkruara kurrë,
pas të cilave çmendem unë.

Këtu hedh spirancën. Këtu.
Në thellësitë e ujërave të tua.
Në thellësitë e dashurive dhe ëndrrave të mia.
Dhe mbushem me motive të reja,
ulur në breg.
E ngujuar aty,
shkruaj, si gjithmonë, poezi.

Saranda ime!

Ndiej të më ngazëllejë zemra.
Ndiej diellin e ri tek lind.
Udhëton,
 ndriçon botën.
Ndiej këtë qytet që zhaurin.
Njerëz, dallgë, valë, pulëbardha,
ëndërrim...
Dhe anije të vogla e të mëdha me vela të hapura,
që venë e vijnë...

Kur vjen pranvera, dhe dielli si një mik i madh
mbërrin te dera,
është një çast sublim.
Bota vishet me një gjelbërim kumbues këtu.
Lulet çelin si të këndojnë.
Pemë halore që jetojnë me qindra vjet
lëshojnë një fëshfërimë të thekshme
këtu, rreth e rreth,
e që ndihen deri në thellësi të shpirtit të njerëzve,
kur vjen pranvera,
dhe dielli, si një mik i madh, shfaqet te dera.

Zogjtë, zotat e qiellit, nisin fluturimin,
si të entuziazmuar prej meje, prej diellit dhe
shkëlqimit.
Ca zogj çiftohen në një degë të kaltër.
Dehen në idilin e tyre,
qiellor,
i bukur si çiftimi i fluturave në pranverë.
Pastaj të shkrehur,
humbasin nëpër erë...

Dallgët e gëzuara vijnë në breg,
e përplasen në shkëmb.
Stërkalat e ujit kërcejnë lart, në ajër,
si një grusht diamantesh
bregut të artë të Sarandës.

Te ky breg,
mbushur me zhurmat e qeta të valëve,
dritat e mbrëmjes, kur vjen,
dhe një ylber hënor,
pas të cilit mund të magjepsesh,
mund të çmendesh.
Nga çasti në çast, nga ora në orë.

Prej çmendurisë,
imagjinata ime fluturon përtej kufirit të qiellit...
Prej çmendurisë,
ndizen të gjitha ekstazat e frymëzimit.

Prej frymëzimit,
horizonti merr një ngjyrë të artë...
Si të mbushet me pluhur yjesh.
Dhe ti, ti, që s'di ku ndodhesh,
nga ekstazat e tua të frymëzimit.

Në cilën ëndërr?!
Në cilin realitet?!
Në cilën orbitë?!
Në cilin planet?!

Sarandë,
trill, a e vërtetë?!

E magjepsur, fund e krye.
Unë, unë dhe muza ime.
Imagjinata poetike,
këtu,
një imagjinatë,
gati biblike.

Dhe unë që endem kësaj përralle, si një fëmijë i hutuar.
Herë duke qarë.
Herë duke kënduar.

Ndërsa dielli po fshihet, yjet nisin të dalin
si të qëndisin këtë qiell,
këtë shpirt,
dhe një ndjesi poetike,
që ndizet, ndoshta, te kushdo.
Te të gjithë.

Ndërsa dielli po fshihet,
unë nis e jetoj një përmallim të vërtetë.
Një ndjenjë të përjetshme malli për atë diell që ikën,
për këtë qiell,
për këto yje që ndizen,

për këtë det që kam para syve
që ka marrë këtë çast një trajtë të argjendtë.

Ç'mbrëmje e mrekullueshme!

Ç'mrekulli e pabesueshme!

Që të çmend.

Të marros.

Që të tret.

Që të fton të thurësh vargje,
je apo s'je poet.

Dhe ne, si të udhëtojmë më shpejt se drita
vijmë tek ti, Sarandë!

Kridhemi në universin tënd të kaltër,

në këtë univers që vetëm vezullon,

dhe shpirti si një kanarinë e magjepsur

vetvetiu, nis të këndojë.

Këtu, buzë këtij detit që vjen e përplasat në breg.

Dhe përhap në ajër miliarda pikëza të arta,

bregu ynë i detit:

Saranda!

Saranda, ky vend i shndritshëm.

Në kraharorin e saj, një shpirt i shndritshëm.

Një shpirt që lahet me një dritë të vazhdueshme
dhe ndjek, këmba-këmbës, poezinë.
Poezinë që këtu,
si nga dheu mbin.
Dhe era e detit.
Dhe fladi që fryn.
Dhe krahët e pulëbardhave që e përhapin,
si ta mbështjellin me poezi gjithësinë.
Si ta zhytin këtë botë në dëlir.
Botën,
dhe shpirtin e njeriut që këtu dehet,
dhe, si i dehur, mbushet me frymëzim.

Saranda!

Njerëzit e këtushëm,
si të larë me dritë, si në det,
të gjithë.
Edhe nëse vjen për një ditë.
Edhe nëse vjen për një çlodhje.
Edhe nëse vjen për një argëtim,
thjesht për një qejf,
do të lahesh me dritë këtu,
si të lahesh në det.

Ejani në Sarandë!
Në këtë realitet të ëndërrt mbushur me pulëbardha,
njerëz.
Valë të kaltra,
dhe një idil jete,
që nuk resht.

Jetë, o jetë!
Sarandë, o mrekulli!
Trill, a e vërtetë?!

Këtu ke dëshirë të ëndërrosh...
Këtu ke dëshirë të lodrosh...
Në botë të tjera, po kaq të bukura, të nesërmen,
të udhëtosh.
Të nisesh me yllin e parë.
Të shkosh tek yjet më të afërta,
e prej andej,
në yjet e largëta, në botën pa fund e pa anë!

Udhëtojnë ëndërrimet e mia
përtej përfytyrimit tim.
Marrin rrugët qiellore, tutje, në hapësirë...
Në hapësirën që shndrit.